

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
Api – Kzi. 7/2012
23 prill 2013

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Martti Harsia si Kryetar i kolegit dhe gjyqtarët e Gjykatës Supreme Nazmije Ibrahimi dhe Avdi Dinaj si anëtarë të kolegit, të ndihmuar nga Këshilltarja ligjore Lendita Berisha duke vepruar në cilësinë e procesmbajtës,

Në lëndën penale kundër të pandehurve:

H.G

T

I shpallur fajtor në shkallën e dytë me aktgjykimin Ap-Kz 373/10 për veprat penale *Vrasje* në kundërshtim të nenit 146 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së), *Vrasje* në tentativë në kundërshtim të nenit 146 në lidhje me Nenin 20 të KPK-së, dhe *Mbajtje* në pronësi, në kontroll, në posedim dhe shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të nenit 328 paragrafit 1 të KPK-së; i dënuar me dënim unik prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) viteve burgim sipas nenit 71 dhe nenit 147 pikës 11 të KPK-së, dhe

K.S

I shpallur fajtorë me aktgjyimin e shkallës së parë P.nr.24/09 për veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim dhe shfrytëzim të paautorizuar të Armëve në kundërshtim të nenit 328 paragrafi 1 të KP-së; i dënuar sipas aktgjykit të ndryshuar të shkallës së dytë Ap-Kz 373/10 me një (1) vit dhe gjashtë (6) muaj burgim.

H.G

A.H.

A.V

Duke vepruar në lidhje me ankesat e paraqitura nga avokati mbrojtës¹ në emër të pandehurit [REDACTED] dhe avokatit mbrojtës [REDACTED] në emrë te pandehurit Kasurin Gashit, kundër [REDACTED], kimit Ap-Kz 373/10 të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 7 shkurt 2012, dhe duke pasur parasysh përgjigjen e përfaqësuesit ligor të palës së dëmtuar avokatit [REDACTED] në lidhje me ankesën e [REDACTED] dhe përgjigjen e Prokurorit Publik si dhe mendimin nga Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPShK-së) të paraqitur më 13 nëntor 2012.

A.V

H.G

K.G

H.G

Pas mbajtjes së seancës publike më 23 prill 2013 në prani të pandehurit avokatit të tij mbrojtës [REDACTED] të pandehurit [REDACTED] avokatit [REDACTED] dhe përfaqësues i palës së dëmtuar [REDACTED] në prani të Prokurores së Shtetit Judit Eva Tatrat, pas këshillimit dhe votimit të mbajtur në të njëjtën ditë;

J.G

H.J

Duke vepruar sipas nenit 430 paragrafit 2 dhe neneve 420 dhe në vijim të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së), lëshon këtë:

AKTGJYKIM
A.V

1. Ankesa e avokatit nbrojtës [REDACTED] -pranohet pjesërisht.

Aktgjyki i Gjykatës Supreme të Kosovës Ap-Kz 373/10 i datës 7 shkurt 2012, ndryshohet.

I pandehuri [REDACTED] shpallet fajtor për veprën penale Vrasje në kundërshtim të nenit 146 të KPK-së, sepse më 20 shtator 2008 rrëth orës 13:00, në lagjen "Gashi", në fshatin Kryshevc, Komuna e Skenderajt me pushkë automatike AK 47 të kalibrit 7,62 x 39mm me numër serik C-43367 ka shkrepur 10 të shtëna në drejtim të [REDACTED] duke e goditur dhe në këtë mënyrë duke shkaktuar vdekjen e menjëherëshe të [REDACTED].

I pandehuri [REDACTED] shpallet fajtor për veprën penale Vrasje në tentativë në kundërshtim të nenit 146 në lidhje me nenin 20 të KPK-së, sepse më 20 shtator 2008 rrëth orës 13:00, në lagjen "Gashi", në fshatin Kryshevc, Komuna e Skenderajt me pushkë automatike AK 47 të kalibrit 7,62x39mm me numër serik C-43367 ka shkrepur 10 të shtëna në drejtim të [REDACTED] duke e goditur dhe në këtë mënyrë duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore [REDACTED] në krahun e djathtë.

I pandehuri [REDACTED] shpallet fajtor për veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim dhe shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të nenit 328 paragrafit 2 të KPK-së.

Prandaj i pandehuri është dënuar si në vijim:

- për veprën penale Vrasje sipas nenit 146 të KPK-së, i pandehuri dënohet me dymbëdhjetë (12) vite burgim;
- për veprën penale Vrasje në tentativë sipas nenit 146 në lidhje me nenin 20 të KPK-së, i pandehuri dënohet me tri (3) vite burgim;
- për veprën penale Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim dhe shfrytëzim të paautorizuar të armëve sipas nenit 328 paragrafit 2 të KPK-së, i pandehuri dënohet me një (1) vit e gjashtë (6) muaj burgim;

Në bazë të nenit 71 paragrafëve 1 dhe 2, nën-paragrafit 2 të KPK-së, i pandehuri [REDACTED] dënohet me dënim unik prej pesëmbëdhjetë (15) viteve dhe gjashtë (6) muajve burgim.

Koha e kaluar në paraburgim do të llogaritet sipas nenit 73 paragrafit 1 të KPK-së.

2. Pjesët e mbeturat të ankesës refuzohen si të pabazuara dhe aktgjykinii vërtetohet në pjesët e mbeturat.

K.G

3. Ankesa e paraqitur nga avokati mbrojtës në eniér të pandehurit HEDHET POSHTË si e palejueshme.

Arsyetim

I. Historia e procedurës

S.G.

K.G

A.G.

Procedura penale në këtë lëndë ka të bëjë me një ngjarje e cila ka ndodhur më 20 shtator 2008, rreth orës 13:00 në fshatin Kryshec, Komuna e Skenderajt. Pas mosmarrëveshjeve në mes të dy familjeve fqinje, [REDAKTUE] dhe vëllai i tij [REDAKTUE] kanë shkuar në shtëpinë e [REDAKTUE] dhe [REDAKTUE] dhe [REDAKTUE] kanë shtënë me armët e tyre në drejtim të tjerëve. [REDAKTUE] është qëlluar për vdekje dhe [REDAKTUE] është plagosur në krahun e djathtë.

H.G

A.G

K.G

H.G

K.G

Më 10 mars 2009, Prokurori i EULEX-it ka ngritur aktakuzën PP.Nr. 104/2008 kundër [REDAKTUE] dhe [REDAKTUE] Aktakuza është konfirmuar me aktvendimet KA.nr.24/2009 të datës 11 janar 2010.

H.G

Më 10 qershor 2010, ripi gjykues i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë ka lëshuar aktgjykimin me të cilin:

H.G

[REDAKTUE] është shpallur fajtor për Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim dhe shfrytëzim të paautorizuar të armëve sipas nenit 328 paragrafit 2 të KPK-së, dhe është dënuar me katër (4) vite burgim.

H.G

Sipas nenit 390 pikës 3 të KPPK-së, i pandehuri [REDAKTUE] është liruar nga akuza për Vrasje në kundërshtim të nenit 146 të KPK-së dhe Vrasje në tentativë në kundërshtim të nenit 146 në lidhje me nenin 20 të KPK-së.

K.G.

[REDAKTUE] është shpallur fajtor për Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim dhe shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të nenit 328 paragrafit 2 të KPK-së, dhe është dënuar me tri (3) vite burgim; dhe i pandehuri i tretë [REDAKTUE] është liruar nga të gjitha akuzat.

S.G.

Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut është apeluar nga Prokurori Publik, të pandehurit [REDAKTUE] dhe [REDAKTUE] dhe pala e dëmtuar.

H.G

K.G

Pas seancës së mbajtur më 7 shkurt 2012, Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykimin e saj Ap-Kz nr. 373/2010 ka ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë si në vijim:

H.G

Ankesa e paraqitur nga Prokurori Publik i Qarkut është pranuar dhe ankesat e paraqitura në emër të [REDAKTUE] dhe [REDAKTUE] janë pranuar pjesërisht dhe ankesa e palës së dëmtuar është refuzuar si e papranueshme.

K.G

I pandehuri [REDAKTUE] është shpallur fajtor për veprën penale Vrasje në kundërshtim të nenit 146 të KPK-së dhe Vrasje në tentativë në kundërshtim të nenit 146 në lidhje me nenin 20 të KPK-së, sepse më 20 shtator 2008 rreth orës 13:00, në lagjen "Gashi", në fshatin Kryshec, Komuna e Skenderajt me pushkë automatike AK 47 të kalibrit 7.62 x 39mm me numër serik C-43367 ka shkrepur 10 të shtëna në drejtim të [REDAKTUE] dhe [REDAKTUE] duke e goditur dhe në këtë mënyrë duke shkaktuar vdekjen e menjëherështë të [REDAKTUE]

A.G

A.G

dhe duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore
majtë.

H.G

I pandehuri [REDACTED] gjithashtu është shpallur fajtor edhe për veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim dhe shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të nenit 328 paragrafit 2 të KPK-së.

H.G

I pandehuri [REDACTED] është dënuar me pesëmbëdhjetë (15) vite burgim sipas nenit 147 pikës 11 të KPK-së për veprat penale Vrasje dhe Vrasje në tentativë.

Dënim prej katër (4) viteve i shqiptuar ndaj të pandehurit për veprën penale Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim dhe shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të nenit 328 paragrafit 2 të KPK-së nga gjykata e shkallës së parë është ndryshuar në një (1) vit e gjashtë (6) muaj burgim.

H.G

Sipas nenit 71 të KPK-së, Gjykata Supreme ka dënuar të pandehurin [REDACTED] me dënim unik prej gjashtëmbëdhjetë (16) viteve burgim.

K.G

Në lidhje me të pandehurin [REDACTED], dënim prej tri (3) viteve burgim i shqiptuar ndaj të pandehurit nga gjykata e shkallës së parë për veprën penale Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim dhe shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të nenit 328 paragrafit 2 të KPK-së është ndryshuar në një (1) vit e gjashtë (6) muaj burgim.

Më 7 shkurt 2012, Gjykata Supreme me aktvendimin e saj Ap-Kz nr. 373/2010 ka caktuar paraburgimin kundër [REDACTED].

A.V

H.G

H.G

Ankesat kundër aktgjykit të Gjykatës Supreme të Kosovës janë paraqitur nga avokati mbrojtës [REDACTED] në emër të pandehurit [REDACTED] më 30 mars 2012, nga avokati mbrojtës [REDACTED] në emër të pandehurit [REDACTED] më 5 prill 2012.

A.H

K.G

H.J

Përgjigja e përfaqësuesit ligor të palës së dëmtuar avokatit [REDACTED] ndaj ankesës së [REDACTED] është paraqitur më 12 prill 2012, dhe e Prokurorit Publik më 19 prill 2012.

H.G

Mendimi i Zyrës së Prokurorit të Shtetit të Kosovës është dorëzuar më 13 nëntor 2012.

II. Parashtresat e palëve:

II.1 Ankesa e të pandehurit

H.G

Në ankesën e tij avokati mbrojtës pretendon në shkelje substanciale të dispozitave të ligjit të procedurës në kuptim të nenit 403 paragrafit 1, pikave 10 dhe 12, paragrafit 2, pikës 1 të KPPK-së, shkelje të ligjit penal në kuptim të nenit 404 paragrafit 2 të KPPK-së dhe vendimin mbi dënimin sipas nenit 406 paragrafit 1 të KPPK-së. Mbrojtja i propozon Gjykatës Supreme të Kosovës që ta anulojë aktgjykitin dhe lëndën ta kthejë në rigjykit në Gjykatën Supreme, ose ta ndryshojë aktgjykitin e kundërshtuar dhe të pezullojë procedurën penale ose ta hedhë poshtë aktakuzën sipas nenit 384 paragrafit 1 pikës 3, në lidhje me nenin 386 paragrafin 1 dhe nenin 390 paragrafin 1 pikën 2 të KPPK-së.

Mbrojtja pohon se gjykata e shkallës së dytë nuk ka vepruar drejtë gjatë ndryshimit të aktgjykit të shkallës së parë dhe ka shpallur të pandehurin fajtor për veprat penale Vrasje

në kundërshtim të nenit 146 të KPK-së dhe Vrasje në tentativë në kundërshtim të nenit 146 të KPK-së në lidhje me nenin 20 të KPK-së, dhe gabimisht ka zbatuar dispozitat e nenit 147 pikës 11 të KPK-së gjatë dënimit të tij me pesëmbëdhjetë (15) vite burgim, duke pasur parasysh se ky nen (147 i KPK-së) ka të bëjë me veprën penale të cilësuar vrasje.

Mbrojtja thekson se arsyetimi i aktgjykimit të kundërshtuar është jo logjik sepse për të njëjtën situatë janë bërë vlerësimë të ndryshme nga gjykata e shkallës së parë në krahasim me gjykatën e shkallës së dytë, duke ju referuar gjetjeve të kolegjit të Gjykatës Supreme "...se të gjitha faktet relevante janë vërtetuar nga Gjykata e Qarkut dhe pastaj pjesërisht janë vlerësuar ndryshe.

Sipas mbrojtjes, gjykata e shkallës së dytë mund ta ndryshoj aktgjykiimin e gjykatës së shkallës së parë nga ana procedurale mirëpo është e pakuptueshme kur i vlerëson provat e administruara drejtpërdrejt nga gjykata e shkallës së parë krejtësisht në mënyrë të ndryshme. Është e paqartë për mbrojtjen se si mundet gjykata e shkallës së dytë ta vërejë agresivitetin e anëtarëve të familjes së [REDACTED] (siç është theksuar në faqen 12 të aktgjykimit) dhe pastaj të vlerësojë se kërcënimi i hedhjes së bombës në shtëpi nuk ka qenë real, mirëpo ka qenë akt i shprehjes së dëshpëruar të zemërimit.

[J.G]

H.G

M.G

Mbrojtja pohon se nuk është e kontestueshme se i pandehuri [REDACTED] në ditën kritike ka vepruar në mbrojtje të domosdoshme sipas nenit 8 paragrafëve 1 dhe 2 të KPK-së pasi që ai ka shtënë për t'iu shmangur sulmit të kundërligjishëm, drejtpërdrejtë, real dhe të menjëhershëm. Kjo është vërtetuar me anë të dëshmisë së dëshmitarëve Muç dhe [REDACTED] – të dy Policë. Pastaj ekspertiza e Drejtorisë së Mjekësisë Ligjore në Zagreb – Dega e Toksikologjisë në Zagreb ekspertiza nr.511 - 01 - 115/1 - 11674 - 08 VN e datës 13 janar 2009 ka konfirmuar përdorimin e armës nga [REDACTED]. Më tutje, në bazë të raportit të mjekësisë ligjore të laboratorit të mjekësisë ligjore të PK-së armët dhe pesë gëzhojat e kalibrit 7.62 x 25 mm të gjetura në vendin e krimit në ditën kritike janë shtënë nga arma e të pandehunut [REDACTED]. Gjithashtu, fotografitë e bëra në vendin e krimit tregojnë dëmet e shkaktuara në dritaret e dhomës ku ishte duke qëndruar i pandehuri [REDACTED]. Në bazë të kësaj, është provuar se sulmi kundër familjes së [REDACTED] nuk ka qenë i intensitetit të ulët apo i parëndësishëm.

J.G

K.G

H.G

A.G

H

K.G

Për më tepër, i pandehuri nuk ka proceduar me sulmin kundër [REDACTED] dhe [REDACTED] pasi që ata e kanë ndërprerë sulmin mirëpo gjersa ka qenë duke u sulmuar me armë nga ata. Mbrojtja citon gjetjet e Gjykatës Supreme të Serbisë në vendimin Kzl nr.260/70 e drejta për mbrojtje të domosdoshme pushon së ekzistuari apo që sulmi të ketë mbaruar.

Më tutje, fakti se në ditën kritike i pandehuri ka përdorur pushkë automatike kundër palës tjetër i cili ka pasur revole nuk e përashton automatikisht mundësinë që ai të ketë vepruar në mbrojtje të domosdoshme. Në- lidhje me këtë, mbrojtja i referohet vendimit të Gjykatës Supreme të Kroacisë Kz nr.1298/67 ku gjykata gjen gjatë diskutimit të mbrojtjes së domosdoshme – intensiteti i sulmuesit dhe ekuivalanca në mes të sulmit dhe mbrojtjes nuk mund të vlerësohet ekskluzivisht mbi bazën e mjetit të përdorur, mirëpo intensiteti patjetër duhet të vlerësohet në të gjitha rrëthanat në të cilat është kryer vepra penale dhe pastaj të vlerësohet gjithashtu se çfarë mjeti mbrojtës ka pasur në posedim personi i sulmuar në mënyrë që të jetë në gjendje që ta mënjanoj sulmin.

II.2.. Ankesa e të pandehurit

K.G

Avokati mbrojtës ka paraqitur ankesë mbi bazën e vendimit mbi sanksionimin penal dhe shpenzimet e procedurës penale. Mbrotja i propozon Gjykatës Supreme që ta ndryshojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë dhe ta lirojë të pandehurin nga akuza apo ti shqiptoj atij një gjobë apo dënim me kusht.

III.3 Përgjigja e Prokurorit Publik të Qarkut të EULEX-it në Mitrovicë në ankesën e avokatit mbrojtës të të pandehurit

H.G.

H.G.

Prokurori Publik të Qarkut të EULEX-it që ankesa e të pandehurit të refuzohet si e pabazuar.

H.G.

Prokuroria në përgjigjen e saj pohon se avokati mbrojtës bë ankesën e tij ka pranuar se i pandehuri nuk ka qenë i ballafaquar me "trezik të kundërligjshëm dhe eminent në drejtim" të tij apo anëtarëve të familjes së tij.

Prokuroria thekson se deklarata e avokatit mbrojtës (duke iu referuar faqes 5, paragrafit 2 të versionit në gjuhën angleze të ankesës) në mënyrë të qartë demontron se sulmi eminent dhe i kundërligjshëm (siç besohet nga i pandehuri) ishte ndalur. Sipas kësaj, i pandehuri ka besuar se babai i tij ishte vrarë pasi që një anëtar i familjes kishte bërtitur, pra në atë moment sulmi i kundërligjshëm dhe eminent kishte mbaruar. Ka qenë pas kësaj kur i pandehuri ka marrë armën automatike dhe nga ballkoni i shtëpisë ka shtënë dhe ka vrarë dhe ka lënduar rëndë.

K.G

A.G

Më tutje, fakti se i pandehuri kishte 22 plumba dhe se ka pasur mundësi që t'i shtijë ata është tërësisht jo relevant. Në këtë fazë nuk është e rëndësishme mundësia potenciale, mirëpo nëse veprimet e të pandehurit kanë qenë të domosdoshme për të shmangur një sulm të kundërligjshëm, eminent dhe real.

III.4 Përgjigja e palës së dëmtuar në ankesën e avokatit mbrojtës të të pandehurit

H.G.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar i propozon Gjykatës Supreme që ta refuzojnë ankesën si të pabazuar dhe ta vërtetojë aktgjykimin e shkallës së dytë.

III.5. Mendimi i ZPSHK-së

K.G

H.G

ZPSHK-ja i propozon Gjykatës Supreme që:

- Të hedh poshtë ankesën e të pandehuri si të papranueshme, në pajtim me nenit 422 dhe 430 paragrafin 1 të Kodit të Procedurës penale të Kosovës (KPK-së);
- Të ndryshojë vendimin e kundërshtuar duke e larguar referimin në nenin 147, pikën 11 të KPK-së dhe, sipas nenit 71 të KPK-së, t'i shqiptoj një dënim unik (të njëjtin tanimë të shqiptuar apo ndonjë dënim tjetër i cili konsiderohet si i përshtatshëm) për veprat penale aktuale Vrasje në kundërshtim të nenit 146 të KPK-së, Vrasje në tentativë në kundërshtim të nenit 146 dhe 20 të KPK-së dhe Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posëdim dhe shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të nenit 328 paragrafit 2 të KPK-së;
- Të vërtetojë pjesën e mbetur të aktgjykimit të kundërshtuar.

Në kundërshtim me gjetjet e kolegit të shkallës së dytë, Prokurori i Shtetit konsideron se vrasja dhe vrasja në tentativë për të cilat akuzohet i pandehuri nuk janë kryer në kuadër të ngjarjes së njëjtë. Ato kanë qenë ngjarje në veteve, përkatësisht dy ngjarje të ndara të cilat kanë sulmuar dy vlera të mbrojtura nga sistemi ligjor: jeta e [REDACTED] nga e cila viktima është privuar dhe jeta e [REDACTED] e cila është prezkuar.

K.G

A.G

Prokurori i Shtetit pohon se pika 11 e nenit 147 parashevë rrethanat rënduese të kryerjes së qëllimshme të dy apo më tepër vrasjeve si një ngjarje e përfunduar e cila ka rezultuar në vdekjen e viktimate.

Më tutje, pika në fjalë vetëm vërteton një rrethanë rënduese dhe nuk është paraparë për arsyet e shqiptimit të dënimt të unifikuar për veprat penale në bashkim në bazë të faktit se kryerësi ka vepruar me dashje të unifikuar.

Prokurori i Shtetit i referohet komentit të nenit në korrespondues 47, paragrafit 2, pikës 6 të Ligjit Penal të Serbisë, 1995, botimi i 5-të:

Vepra penale [p.sh. marrja e jetës së disa personave me dashje të paramenduar] ekziston vetëm atëherë kur dy apo më tepër persona janë provuar nga jeta. Nëse vetëm një person është privuar nga jeta dhe ka pasur tentativë për të privuar personin tjetër nga jeta, kjo nuk përbën vrasje në tentativë nga pika 6 nëse kryerësi ka paramenduar vrasjen e disa personave; në të kundërtën, kjo do të konsiderohet një bashkim real në mes të vrasjes së kryer dhe në tentativë. Kjo vepër ekziston në formën e tentativës kur dy apo më tepër vrasje janë filluar përmes paramendimit mirëpo asnjëra nuk ka përfunduar.

Si i tillë, mendimi i Prokurorit të Shtetit është se në rastet si ky, ngritët vetëm çështja e 'bashkimit' në mes të vrasjes dhe vrasjes në tentativë sipas nenit 71 të KPK-së.

III. Gjetjet e Gjykatës

1. Ligji i aplikimit

Sipas nenit ¹ të Mendimit juridik Nr.56/2013 të datës 23 janar 2013 të Gjykatës Supreme të Kosovës kjo lëndë do të gjykohet sipas ligjit të vjetër të procedurës duke pasur parasysh se procedura penale ka filluar para hyrjes në fuqi të ligjit të ri të procedurës.

2. Përbirja e kohës

Kolegji i Gjykatës Supreme është përbërë nga tre gjyqtarë në bazë të nenit 28 paragrafit 2 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 3.7 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të UELX-it në Kosovë, Ligji nr. 03/L-053.

Është qasje unike e Gjykatës Supreme se megjithatë kushteve të përcaktuara me nenin 2 të Mendimit juridik dhe nenit 26 paragrafit 2 të KPPK-së², Gjykata Supreme gjithmonë gjykon në kolegje të përbëra nga tre gjyqtarë.

¹ Në procedurat penale të filluara para hyrjes në fuqi të këtij Kodi për të cilën shqyrtimi gjyqësor tanimë ka filluar, mirëpo nuk ka përfunduar dispozitat e Kodit të vjetër do të aplikohen përshtatshmërisht derisa vendimi të bëhet i formës së prerë.

Neni 430 paragrafi 1 i KPPK-së përcakton se ankesa kundër gjykatës së shkallës së dytë mund të paraqitet vetëm nëse gjykata e shkallës së dytë ka shqiptuar një dënim me burgim afatgjatë apo nëse ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë me anë të cilës shqiptuar një dënim i tillë; apo nëse gjykata e shkallës së dytë pas mbajtjes së shqyrtimit ka bërë një vërtetim të gjendjes faktike të ndryshëm nga gjykata e shkallës së parë dhe ka bazuar aktgjykimin e saj në gjendjen e vërtetuar faktike të tillë; apo nëse gjykata e shkallës së dytë ka ndryshuar aktgjykimin lirues të gjykatës së shkallës së parë dhe në vend të tij ka lëshuar aktgjykim fajësues.

Në lëndën në fjalë, gjykata e shkallës së dytë ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor për veprën penale Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim dhe shfrytëzim të paautorizuar të arnëve në kundërshtim të nenit 328 paragrafit 2 të KPK-së dhe ka ndryshuar aktgjykimin në lidhje me dënimin e shqiptuar duke zvogëluar dënimin në një (1) vit dhe gjashtë (6) muaj burgim.

Ligji përcakton rrëthanat në të cilat i pandehuri ka të drejtë të kundërshtoj aktgjykimin. Në lëndën në fjalë, sa i përket të pandehurit, **K.G.**, aktgjyki i gjykatës së shkallës së dytë është i formës së prerë; prandaj i pandehuri nuk ka të drejtë që të paraqes ankesë.

Gjkata Supreme konsideron se ankesa e të pandehurit është e palejueshme pasi që nuk përmbrush kushtet e përcaktuara me nenin 430 paragrafin 1 të KPPK-së dhe është dashur të hedhet poshtë me aktvendim sipas nenit 422 të KPPK-së.

1. *Lëllur me autorin e të pandehurit*

H.G

Gjkata Supreme gjendet se ankesa është e pranueshme, e paraqitur me kohë dhe nga personi i autorizuar.

Aktgjyki i ankimuar është shpallur më 7 shtator 2012. Aktgjyki i është dorëzuar të pandehurit dhe avokatit të tij mbrojtës më 16 mars 2012.

Ankesa e avokatit mbrojtës është paraqitur më 30 mars 2012.

A.V

K.S

H.G

Gjkata Supreme e Kosovës ka mbajtur seancën e saj të kolegji në pajtim me dispozitat e nenit 410 të KPPK-së; në seancë gjithashtu kam arrë pjesë edhe i pandehuri [REDAKTUE] dhe avokati i tij mbrojtës [REDAKTUE] i pandehuri [REDAKTUE] përfaqësuesi i palës së dëmtuar avokati [REDAKTUE] dhe Prokurorja e Shtetit Judit Eva Tatrat.

H.J

Gjkata Supreme e Kosovës ka shqyrtuar shkresat e lëndës si dhe aktgjykimin e kundërshtuar me ankesë, duke i ekzaminuar ato sipas dispozitave të nenit 415 të KPPK-së; Gjkata Supreme pastaj ka shqyrtuar përgjigjen e paraqitur nga Prokurori Publik dhe mendimin e paraqitur nga Zyta e Prokurorit të Shtetit duke arritur në përfundimet në vijim.

Kolegji i Gjykutës Supreme të Kosovës gjatë vendosjes në shkallën e trete në lidhje me ankesën kundër aktgjykimit është shkallë e dytë duke i treguar një kolegji të përbërë nga pesë gjyqtarë.

Avokati mbrojtës, përfaqësuesi i palës së dëmtuar dhe Prokurorja e Shtetit kanë qëndruar tërësisht pranë parashtresave dhe propozimeve të tyre.

H.G

Ankesa e paraqitur nga avokati mbrojtës i të pandehurit [REDACTED] pranohet pjesërisht.

i. Njëkëndëshim i gjykatës

Avokati mbrojtës pretendon në shkelje të ligjit penal nga gjykata e shkallës së dytë në dëm të pandehurit, pasi që ai-është shpallur fajtor për veprat penale Vrasje dhe Vrasje në tentativë sipas nenit 146 të KPK-së.

Gjykata Supreme në veçanti ndan vlerësimin ligjor të gjykatës së shkallës së dytë siç është theksuar nën pikën "C. Meritat e ankesës / në lidhje me të pandehurin [REDACTED]" (faqet 11 – 13 të versionit në gjuhën angleze).

H.G

Gjykata Supreme gjen se pretendimet mbrojtjes se veprimet e të pandehurit duhet të konsiderohen si mbrojtje e domosdoshme janë të pabazuara. Kolegji vëren se ekzistojnë disa argumente të cilat përjashtojnë mundësinë se i pandehuri të ketë vepruar në mbrojtje të domosdoshme të cilat janë të qarta dhe të identifikuara në mënyrë të drejtë nga gjykata e shkallës së dytë.

K.G

Nga shkresat e lëndës dhe nga shqyrtimi gjyqësor është vërtetuar se i pandehuri [REDACTED] në ditën kritike ka qenë në shtëpi dhe në këtë mënyrë ai ka pasur një strehim relativisht të sigurt dhe vetëm në mënyrë indirekte ka qenë i ekspozuar ndaj të shtënave nga jashtë. Nga zhvillimi i ngjarjes, është e qartë se i pandehuri ka dalë jashtë dhe ka filluar të shtijë vetëm pasi të shtenat nga pala tjetër (nga [REDACTED] tjetër ienë ndalur. Kolegji konsideron se është e pakontestueshme se në atë moment i pandehurit ka dalë në ballkonin e shtëpisë së tij dhe ka filluar të shtijë pasi që sulmi i kundërligjshëm dhe i menjëhershëm të ketë mbaruar.

H.G

Më tutje, është e qartë se qëllimi i të pandehurit nuk ka qenë që t'i frikësojë viktimat. Përndryshe i pandehuri do t'i paralajmëronte ata duke qëlluar në ajër apo në ndonjë drejtim tjetër, por jo ashtu siç ka vepruar duke shtënë drejtpërdrejtë në viktimat duke shkaktuar vdekjen e të parit dhe lëndimin e rëndë të personit të dytë. Përveç kësaj, personi i cili vepron në mbrojtje të domosdoshme nuk do ta ndjek agresorin i cili është duke mbajtur revole nga një pozitë më e lartë, nga një distancë relativisht e shkurtër dhe me pushkë automatike.

Prandaj, kolegji i poshtë-nënshkruar konstaton se arsyet e dhëna [REDACTED] mbrojtja se i pandehuri ka menduar se babai i tij ishte pastaj një anëtarë i familjes së tij kishte bërtitur dhe pastaj ai kishte marrë armë [REDACTED] në ballkonin e shtëpisë së tij dhe gjersa nuk ishte në gjendje që të shikoj përreth për shkak të shtënave në drejtim të tij, ka shtënë me pushkë automatike pa e ditur drejtimin në të cilin ishte duke shtënë, janë të papranueshme.

H.G

Përfundimisht, Gjykata Supreme pajtohet me gjetjet e gjykatës së shkallës së dytë se i pandehuri [REDACTED] ka kryer veprën penale Vrasje në kundërshtim të nenit 146 të KPK-së duke privuar [REDACTED] ngajeta dhe veprën penale Vrasje në tentativë në kundërshtim të nenit 146 në lidhje me nenin 20 të KPK-së duke e lënduar [REDACTED]

K.G

A.G

H.G

Në bazë të aktgjykimit të ankimuar i pandehuri [REDACTED] është shpallur fajtor për tri vepra penale: Vrasje në kundërshtim të nenit 146 të KPK-së, Vrasje në tentativë në kundërshtim të nenit 146 në lidhje me nenin 20 të KPK-së, dhe veprën penale Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim dhe shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të nenit 328 paragrafit 2 të KPK-së.

H.G

I pandehuri [REDACTED] është dënuar nga gjykata e shkallës së dytë me pesëmbëdhjetë (15) vite burgim sipas nenit 147 pikës 11 të KPK-së, pasi që ka konstatuar se veprat penale Vrasje dhe Vrasje në tentativë janë kryer në të njëjtën ngjarje, me kushte të ngjashme dhe me dashje të njëjtë të kryerësit.

A.G

K.G

Gjykata Supreme pajtohet me gjetjet e gjykatës së shkallës së dytë se të drejtat e mbrojtura e jetës së [REDACTED] dhe [REDACTED] janë shkalur; sidqoftë konsideron se dënim i shqiptuar ndaj të pandehurit për veprat penale Vrasje dhe Vrasje në tentativë jo [REDACTED]

Kolegji pajtohet me mendimin e Prokurores së Shtetit se këto kanë qenë dy ngjarje të ndara të që kanë sulmuar dy vlera të veçuara nga sistemi ligjor. Për më tepër, të dy veprat penale janë të dënueshme sipas nenit 146 të KPK-së si vepra penale të ndara.

Neni 147 pika 11 e KPK-së parashev se dënim me burgimi me së paku dhjetë vite apo me burgim usfatgjatë do t'i shqiptohet çdo personi i cili qëllimi kryen dy apo më tepër vrasje.

...

Gjykata Supreme sqaron se neni 147 i KPK-së përmban cilësimë të veprave penale si dhe dispozita mbi dënimin për ato veprave të cilësuara. Mirëpo, nuk përcakton se i pandehuri i cili akuzohet apo shpallet fajtor për cilëndo vepër tjetër penale mund të dënohet sipas këtij neni. Dhe si i tillë nuk është i aplikueshëm në këtë lëndë, në të cilën i pandehuri akuzohet dhe shpallet fajtor për veprat penale Vrasje dhe Vrasje në tentativë në kundërshtim të nenit 146 të KPK-së.

Gjykata Supreme në parim pajtohet me faktorët rëndues dhe lehtësues të treguar në aktgjykimin e ankimuar (faqe 14 e versionit në gjuhën angleze).

Prandaj, Gjykata Supreme ndryshon aktgjykimin në lidhje me dënimin e shqiptuar dhe e konsideron të përshtatshme që të dënoj të pandehurin për veprën penale Vrasje në kundërshtim të nenit 146 të KPK-së me dy mbëdhjetë (12) vite burgim dhe për veprën penale Vrasje në tentativë sipas nenit 146, në lidhje me nenin 20 të KPK-së me tri (3) vite burgim.

Për veprën penale Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim dhe shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të nenit 328 paragrafit 2 të KPK-së i pandehuri tanimë është dënuar me një (1) vit dhe gjashtë (6) muaj burgim.

Në bazë të nenit 71 paragrafeve 1 dhe 2, nën-paragrafit 2 të KPK-së, i pandehuri [REDACTED] dënohet me dënim unik prej pesëmbëdhjetë (15) viteve dhe gjashtë (6) muajve burgim.

H.G

Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata Supreme ka vendosur si në dispozitiv.

Kryetar i kolegjit:

Mariti Harsia

Anëtarët e kolegjit

Nazmije Ibrahimë,
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

Avdi Dinaj,
Gjyqtar i Gjykatës Supreme

Prosesmbajtëse

Lendita Berisha
Këshilltare ligjore

Raporti i autorizuar
Qendrën Radiotik

Prishtinë

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Api – Kzi. 7/2012

23 prill 2013
Prishtinë